Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0040

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga,Isa Hasani-Kryetar, Batisha Ibrahimi dhe Kimete Gashi-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "AZ Building Development L.L.C", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Zubin Potok" me nr. të prokurimit: "214-24-11463-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës, më 25/03/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjeserisht e bazuar ankesa e OE "AZ Building Development" L.L.C. me nr. 2025/0040, e datës 14/01/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Zubin Potok" me nr. të prokurimit: "214-24-11463-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Polici.a e Kosovës.

2. Mbetët në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës, datës, 31.12.2024, për aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1. (një) të vendimit.

3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik "AZ Building Development" L.L.C, sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Policia e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 31.10.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Stacionit Policor Zubin Potok" me nr. të prokurimit: "214-24-11463-5-1-1".

Autoriteti Kontraktues në këtë rast ka zhvilluar procedurë të hapur të prokurimit lloji i kontratës për punë me vlerë të parashikuar e kontratës prej 1,164,000.00euro.

AK me datën 31.12.2024 ka publikuar Njoftimi mbi vendimin e për dhënie të kontratës OE "NBT- ING" SHPK.

OE "AZ Building Development" L.L.C me datën 06.01.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. AK me datën 09.01.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 14.01.2025 operatori "AZ Building Development L.L.C." ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0040 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me ketë, me 05.11.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetët në fuqi vendimi për dhënie të kontratës.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE "AZ Building Development" L.L.C

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 1 Qëllimi për arsyen në vijim: Qëllimi i aktivitetit është marrja e furnizimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe si rrjedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Oferta e juaj është e pa përgjegjshme për shkak te gabimeve aritmikore në paramasë dhe parallogari te çmimi për njësi ku është dashur te mblidhen disa pozicione ne mënyrë te japin çmimin për njësi sipas paramases. Andaj, Pretendimi ankimor është i pa bazuar. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti. Autoriteti kontraktues nuk ka bërë shkelje të Nenit 6 të LPP-se të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Ne këtë aktivitet te prokurimi Autoriteti kontraktues duke marre ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit fondet publike i ka përdorë ne mënyrën ekonomike pasi qe oferta e Juaj ka gabime aritmikore ne pozicionet çmimet për njësi dhe oferta e juaj është e pa përgjegjshme. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 7 Barazia në Trajtim/ To- Diskriminimi. Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 te LPP-ës nuk qëndron pasi AK, sqaron se gjatë udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, ku te gjithë OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit duke ju përfshirë edhe juve si ankues i ka trajtuar ne mënyrë te barabarte pa diskriminime dhe pa favorizime te asnjë OE, autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Oferta e juaj është e pa përgjegjshëm pasi që keni gabime aritmikore ne pozicionet çmimet për njësi. Pretendimi ankimor është i pa bazuar. Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Andaj AK i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë Operatoret Ekonomik bazuar në kërkesat teknike dhe profesionale te Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë. Gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteteve të prokurimit. AK - Polica e Kosovës do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e

prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, e dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës, FDT që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse dhe AK ka vepruar ne harmoni te plote me LPP- dhe RRLJOPP- ne pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk ka bere shkelje te Nenit 10 Mjetet për promovimin e Transparencës dhe Neni ll: Informatat Sekrete Afariste. Pasi qepër secilin aktivitet të prokurimit duhet të përmbajnë se paku: (i) të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me një aktivitet të prokurimit ose që janë zhvilluar apo pranuar gjatë, ose që janë mbledhur ose shfrytëzuar për të filluar ose përmbyllur një aktivitet të prokurimit, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në një kontratë ose në dhënien e konkursit të projektimit, dhe (ii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në dhënien e një kontrate, atëherë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dhënien e tillë.

Autoriteti kontraktues ka vepruar konform Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 nenit 11 Neni 11 Informatat Sekrete Afariste, pika 1,3.1,3.2,dhe 3.3. Pa prejudikuar detyrimin për t'u siguruar palëve të interesuara dhe publikut çasje në shënimet e aktiviteteve te tij të prokurimit autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen qe atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji, që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues ti mbajë artikujt e tillë si sekret. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 11 te LPP-se si dhe nenin 7 te Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik neni 7 informata Sekrete afariste dhe qasje ne Dokumentacion nen 7.6. Autoriteti kontraktues ka vepruar konform Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 nenit 11 Neni ,11 Informatat Sekrete Afariste, pika 1,3.1,3.2,dhe 3.3 dhe konform nenit 7 te Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik, pasi qe Ofertuesit e rekomanduar kanë plotësuar Aneksin 3 kërkesën për sekret afarist.

AK, sqaron se nuk ka bere shkelje te neve 10 dhe 11 pasi qe Ju me datën 03.01.2025 keni kërkuar qasje ne ofertat e rekomanduara për kontrate, po në atë ditë AK, ju ofron qasje duke ju dërguar njoftimin përmes e prokurimit mirëpo ju si OE nuk jeni paraqitur ne zyrën e prokurimit. Me datën 06.01.2025. Ju jeni paraqitur ne ora 09:30 pranë zyrës se prokurimit për qasje AK sqaron se dy OE e rekomanduar për kontrate kanë plotësuar Aneksin 3 kërkesën për konfidenciale AK sqaron se përfaqësuesit te OE ne qasje ju është afruar komplete

dokumentacioni për të shikuar për te dy pjesët ne zyrën e prokurimit, përfaqësuesi i OE citon qe nuk dua te shikoj dokumente me jep vetëm listat e çmimeve te gjithë OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit. Ju është dhënë lista e çmimeve te të gjithë OE pjesëmarrës. Me poshtë gjeni dokumentin te cilin është nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik.AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 59-dhe Neni 40 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara me njoftimin për kontratë, FDT dhe specifikimet teknike të detyrueshme Aneksi. Andaj AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjithë ofertave në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Prandaj ky pretendim i OE është i pa bazuar. AK sqaron se nuk ka te beje me gabime aritmetikore mirëpo ka te beje me ndryshimin e çmimeve për njësi ne mbledhjen e pozicioneve si është kërkuar.

Andaj oferta juaj për te dy pjesët nuk mund te llogaritet si gabim aritmetikore për arsye se ka te bej me korrigjimin e çmimit për njësi pasi qe është kërkuar mbledhja e pozicioneve dhe nga shuma e mbledhur të shënohet çmimi për njësi sipas pozicionit te kërkuar. Sipas Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 40.11 Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për tenderuesin: pika b. Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr. Nga sqarimet e me sipërme për pozicionet e me sipërme vërehet qe OE nuk i ka mbledhur pozicionet ashtu siç është kërkuar mirëpo ka vendosur çmim për njësi te ndryshëm prej shumes se pozicioneve qe është kërkuara mbledhja e pozicioneve te sipër përmendura. Sa i për këtë kësaj pike te atakuar nga ana e juaj ekzistojnë vendime te OSHP-së ku është trajtuar rasti si ne këtë aktivitet te prokurimit. Për me tepër referojuni vendimeve të OSHP 2023/701 dhe 2023/706 të datës 29.12.2023.

Neni 60 -Kriteret për Dhënien e Kontratës-Pretendimet për shkelje te neni 60 të LPP-së, AK sqaron se nuk ka bërë shkeljen e këtyre neneve pasi që është zbatuar ne përpikeni të plotë ky nenë pasi qe është rekomanduar për kontrate oferta e përgjegjshme me çmimin me te ulet ndërsa oferta e Juaj është oferte e pa përgjegjshme pasi qe ka ndryshime në çmimet për njësi. Prandaj ky pretendimi është i pa bazuar. Pretendimet se AK ka shkelur nenin 69 të LPP-ës, AK sqaroni se OE ankues nuk ka dhënë ndonjë detaj se pse AK ka shkel ketë nenë pasi qe në lidhje me këtë nenë ankuesi nuk është eliminuar mirëpo eliminim ka te beje me çmimet për njësi.

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 72 të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konform kërkesave në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Po ashtu AK nuk kam kërkuar sqarime shtese pasi qe nuk do të sillte asnjë rezultate pozitiv sepse oferta juaj nuk mund te korrigjohet sepse çmimi për njësi nuk korrigjohet ne këtë raste sepse është kërkuar mbledhja e pozicioneve ne mënyrë qe te fitohet çmimi njësi për pozicionin e kërkuar.

Për Pjesën 1 dhe 2 Sipas Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 40.11 Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për tenderuesin: pika b. Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr. Nga sqarimet e me sipërme për pozicionet e me sipërme vërehet qe OE nuk i ka mbledhur pozicionet ashtu siç është kërkuar mirëpo ka vendosur çmim për njësi te ndryshëm prej shumes se pozicioneve qe është kërkuara mbledhja e pozicioneve te sipër përmendura. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AZ Building Development L.L.C."ne ankesën Nr. 0040/2025 janë parashtruar si në vijim:

Neni 1 i LPP-së Neni 6 i LPP-së Neni 7 i LPP-së Neni 10 i LPP-së Neni 11 i LPP-së Neni 59 i LPP-së Neni 60 i LPP-së Neni 62 i LPP-së Neni 69 i LPP-së Neni 72 i LPP-së Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik. Ne me dt.27.12.2024 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku për pjesën 1 është rekomanduar për kontratë OE "NBP-ING SH.P.K me vlerë 684,660.45€, ndërsa për pjesën 2 është rekomanduar GOE "Pro & Co Group SH.P.K; 2A Group SH.P.K me vlerë 397,422.99, ndërsa ne jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si në vijim: OE ka ofertuar për pjesën 1 dhe 2 OE te lista e çmimeve te pozicione e makinerisë pjesa 1 trupat ngrohës/ftohës. Pozicioni 8,16,21 Kaldatorja: Pozicioni 11: ventilimi: pozicioni 3. OE te lista e çmimeve te pozicione e makinerisë pjesa 2 trupat ngrohës/ftohës te pozicioni 8 është gabuar çmimi për njësi Pozicioni 8. Për Pjesën 1 dhe 2 Sipas Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 40.11 Shumat korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për tenderuesin: pika b. Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr. Nga sqarimet e me sipërme për pozicionet e me sipërme vërehet qe OE nuk i ka mbledhur pozicionet ashtu siç është kërkuar mirëpo ka vendosur çmim për njësi te ndryshëm prej shumes se pozicioneve qe është kërkuara mbledhja e pozicioneve te sipër përmendura. Ne kemi kërkuar qasje në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë, mirëpo AK-së ka deklaruar se këta OE kanë plotësuar aneksin 3 për sekret afarist, ndërsa na është dhënë vetëm përshkrimi i çmimeve. Me këtë veprim AK-së nuk ka respektuar nenin 10 të LPP-së dhe nenin 11.4 të LPP-së sepse nuk ka përgatitur versionin e pastruar të dokumenteve të cilësuar sekret afarist. Nuk mund të cilësohet sekret afarist e tërë oferta sepse kjo procedurë e prokurimit është e hapur dhe qasja në dokumente është e drejtë kushtetuese. Sa i përket arsyes së eliminimit, sqarojmë se në këtë rast kemi të bëjmë me gabime aritmetike e të cilat gabime nuk e kalojnë 2% në asnjërën pjesë. Realisht gabimi ka të bëjë 0.26% në vlerën totale të dy pjesëve, prandaj ky gabim aritmetik është minor dhe i papërfillshëm ligjërisht. Neni 59.3 i LPP-së e përcakton qartë se gabimet aritmetike duhet të përmirësohen dhe se gabimi aritmetik nuk mund të jetë më i madh se 2% të vlerës së ofertës. Neni 40.9 i RRPP Nr.001/2022 përcakton qartë, si në vijim: 40.9 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale

të ofertës. a. Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësoj gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B49. në rast se OE në fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjale do të refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. b. Ne rast se shuma e korrigjuar është me shumë se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42. Në këtë rast autoriteti kontraktues nuk ka respektuar këto dispozita por na ka eliminuar p? të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit për të dy pjesët edhe pse kemi dhënë çmimin më të lirë. Në secilin pozicion të cilit i është referuar AK-së nuk kemi ndryshim të çmimit për njësi sepse çmimet për njësi janë dhënë saktë por vetëm tek mbledhja e çmimeve kemi gabim aritmetik. P.sh Çmimi për pozicionin Nr.8 është derivat i çmimit të pozicionit 6 dhe 7 prandaj çmimi për njësi tek pozicioni Nr.6 dhe 7 është i dhënë nga ana jonë dhe ky çmim nuk ndryshon, ndërsa tek pozicioni Nr.8 është dashur vetëm të vendoset çmimi total i pozicionit Nr.6 dhe 7 dhe të nxjerrët 40 %. Pra çmimi total është dashur të vendoset dhe ky është një lëshim teknik, pra gabim aritmetik dhe asgjë tjetër. Për të ilustruar pretendimin tonë dhe arsyen se nuk kemi të bëjmë me ndryshim të çmimeve për njësi, ju lutem analizoni më poshtë ofertën tonë për pjesën 1 për pozicionin Nr.8, ku AK-së pretendon se ka ndryshime të çmimit për njësi.

Nga lista e çmimeve vërehet se çmimi për njësi në pozicionin 6 është dhënë nga ana jonë në vlerë prej 3.10 €, kurse në pozicionin 7 është dhënë 3.40 ?. Pra për të dy këto pozicione kemi dhënë çmim për njësi sikurse edhe për pozicione të tjera ku është dashur të jepen. Në pozicionin Nr.8 nuk është dashur të jepen çmime për njësi por tek ky pozicion është dashur të shënohet vlera totale e pozicionit 6 dhe 7. Çmimi për njësi në pozicionin 6 dhe 7 është i saktë dhe pikërisht nga ky çmim është nxjerr totali i çmimit për këto dy pozicione, ndërsa nga vlera totale e pozicionit 6 dhe 7 nxjerrët çmimi për njësi e pastaj shumëzohet me 40% dhe nxjerret totali i pozicionit 8. Pra, nga ky sqarim kuptohet se operatorët ekonomik nuk kanë pas për obligim të vendosin çmim për njësi tek pozicioni 8, sikurse tek pozicionet tjera duke përfshirë edhe pozicionin 6 dhe 7, mirëpo çmimi për njësi për pozicionin 8 ka qenë i kuptueshëm në momentin që është dhënë çmimi për njësi në pozicionin nr.6 dhe 7 dhe vetëm është dashur të mblidhet çmimi total i pozicionit 6 dhe 7 dhe të vendoset tek rubrika çmimi për njësi në pozicionin Nr.8. Në këtë rast kanë ndodh gabime aritmetike nga ana jonë sepse gjatë mbledhjes së totaleve të pozicioneve 6 dhe 7 është gabuar dhe nuk është vendos shuma e saktë, prandaj në këtë rast kemi të bëjmë me gabime aritmetike. E njëjta situatë me gabime aritmetike është edhe me pozicionet tjera, për poz.16 tek pjesa 1 Trupat Ngrohës dhe Ftohës. Pozicioni Nr.11 tek kaldatorja, pozicioni 3 Ventilimi.

Tek pjesa 2 Trupat ngrohës dhe ftohës pozicioni Nr.8 Pra tek pjesa 2 është vetëm një pozicion, e ku shihet se edhe këtu ekziston gabim aritmetik i pastër. Në të gjitha këto pozicione ka gabime aritmetike e që nuk e kalojnë 2% të vlerës së ofertës totale, as në pjesën 1 e as në pjesën 2, prandaj arsyeja e eliminimit është e pa bazuar. Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.09.01.2025. Fillimisht autoriteti kontraktues vetëm e ka mohuar se i ka shkel dispozitat të cilat ne i kemi pretendu dhe argumentu. Sa i përket nenit 10 dhe 11 të LPP-së, autoriteti kontraktues e ka vendosur në një vendim kërkesat për sekret afarist të OE të

rekomanduar për kontratë, e ku shihet që asnjëri prej OE nuk ka argumentuar dhe arsyetuar kërkesën për sekret afarist. OE e rekomanduar për kontratë kanë plotësuar aneksin 3 për sekret afarist, mirëpo në asnjë mënyrë nuk kanë arsyetuar kërkesën por vetëm e kanë cekur se dokumentet e nenit 68 dhe 69 nuk janë sekret afarist. Sipas nenit 11 paragrafi 3 të LPP-së, kërkesa duhet të arsyetohet dhe të parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik. Duke pasur parasysh këtë dispozitë dhe këto fakte atëherë autoriteti kontraktues nuk është dashur ti merr parasysh kërkesat përkatëse për sekret afarist. Në lidhje me pretendimin tonë ankimor për shkelje të nenit 10 dhe 11, autoriteti kontraktues nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimit tonë ankimor por vetëm ka përshkruar dispozitat e nenit 10, 11 të LPP-së dhe nenit 7 të RRPP Nr.001/2022. Arsyetimi se përfaqësuesit të OE ankues i është ofruar i tërë dokumentacioni për shikim është arsyetim absurd dhe kundërthënës sepse në njërën anë deklarojnë se kanë sekret afarist kompanitë e rekomanduara për kontratë, ndërsa në anën tjetër thuhet se i është ofruar komplet dokumentacioni për shikim përfaqësuesit të OE ankues. Me këtë përgjigje kuptohet që sekreti afarist merret parasysh vetëm nëse kërkohen kopje fizike apo elektronike dokumentet e jo edhe nëse shikohen në kompjuter. Në lidhje me arsyen e eliminimit përkitazi me çmimet, AK-së është përgjigjur si më poshtë: AK sqaron se nuk ka te beje me gabime aritmetikore mirëpo ka te beje me ndryshimin e çmimeve për njësi ne mbledhjen e pozicioneve si është kërkuar. Edhe nga kjo përgjigje e AK-së kuptohet që kemi të bëjmë me gabime aritmetike në mbledhjen e pozicioneve, prandaj nga ky konstatim kuptohet se arsyeja e eliminimit është e pa bazuar. Pretendimi i AK-së se kemi gabime të çmimit për njësi dhe referimi tek neni 40.11 i RRPP Nr.001/2022 është i paqëndrueshëm sepse nuk kemi të bëjmë me gabime për çmim për njësi në këtë rast. Sa i përket vendimit të përmendur të OSHP-së Nr.2023/706 dhe 2023/701, sqarojmë se rasti i këtij vendim nuk ka fare përputhshmëri me rastin konkret, pasi që në vendimin që e ka cekur AK-së rasti ka qenë që nuk janë mbledhur pozicionet e përcaktuara komplet, ndërsa tek rasti ynë ka mbledhje të pozicioneve mirëpo ka gabim aritmetik. Në asnjë mënyrë autoriteti kontraktues nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve ankimore por vetëm ka pohuar se nuk janë shkelur dispozitat përkatëse të cilat ne kemi pretenduar se nuk janë respektuar, prandaj nga kjo përgjigje kuptohet se ne jemi eliminuar pa të drejtë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, kur dihet që në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi

ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë. Në pjesën 1 ne kemi ofertuar me çmim prej 684,245.63 €, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë me çmim prej 684,660.45€. Në pjesën 2 ne kemi ofertuar me çmim prej 305,457.30 ?, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë me çmim prej 397,422.99 ?. Pra në dy pjesët ne kemi çmim më të lirë dhe nuk duhet të lejohet të dëmtohet buxheti i shtetit për gabime aritmetike. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 20/01/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0040/2025, i cili është dorëzuar me datë 03/02/2025.

Lidhur me pretendimet e OE "AZ Building Development L.L.C."eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0040 ka vlerësuar si në vijim:

Ekspertja sqaron se pretendimi i OE-ik se nuk ka ndryshime ne çmimet për njësi , nuk qëndron pasi qe më poshtë do gjeni çmimet për njësi te ofertës te Operatorit ekonomik ankues te cilat ndryshohen si me poshtë:

OE KA OFERTUAR PER PJESEN 1 DHE 2
OE TE LISTA E ÇMIMEVE TE POZICIONE E MAKINERISË **PJESA 1**
TRUPAT NGROHES/FTOHES

Pozicioni 8,16,21

8	Fitingu per gypat aluplat me presim si kthesa, gjysemlidhese, vazhduese, etj., merret 40% e vleres totale per pozicionet 6 - 7.	%	0.4	1,340.00 €	536.00 €
16	Fitingu për gypat e kondenzatit si mbajtësat, kthesat, Y-lidhese, vazhduese etj., merret 40% e vleres totale te pozicionit 15	%	0.4	1,340.00 €	536.00 €

Ne baze te kalkulimi te ofertës pozicioni 8 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij (duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit6 dhe 7) duhet te ishte 1.152.80 e jo 1,340.00 pozicioni 16 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij (duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 15) duhet te ishte 598.00 e jo 1,340.00 pozicioni 21 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij (duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 20) duhet te ishte 480.00 e jo 1,340.00 pozicioni 11 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij (duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 10) duhet te ishte 120.00 e jo 1,340.00. Pozicioni 3 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij (duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 2) duhet te ishte 2.256.00 e jo 1,340.00. pozicioni 8 tek çmimi për

njësi ne baze te ofertës e tij (duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 6 dhe 7) duhet te ishte 740.00 e jo 1,350.00. Dispozitat ligjore te Prokurimit Publik konkretisht te Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik lidhur me çmimet për njësi citohet kështu:

Ne baze te kalkulimi te ofertës

pozicioni 8 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij(duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit6 dhe 7) duhet te ishte 1.152.80 e jo 1,340.00

pozicioni 16 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij (duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 15)duhet te ishte 598.00 e jo 1,340.00

pozicioni 21 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij(duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 20)duhet te ishte 480.00 e jo 1,340.00

pozicioni 11 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij(duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 10)duhet te ishte 120.00 e jo 1,340.00.

pozicioni 3 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij(duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 2)duhet te ishte 2.256.00 e jo 1,340.00.

pozicioni 8 tek çmimi për njësi ne baze te ofertës e tij(duke u bazuar ne çmimin total te pozicionit 6 dhe 7)duhet te ishte 740.00 e jo 1,350.00.

Neni 40 40.11 Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për tenderuesin; a. Në rast se tenderuesi nuk i pranon ato, tenderi i tij do të refuzohet; b. Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr. Andaj duke ju referuar termave ligjor te Prokurimit Publik, ekspertja sqaron se ne listën çmimeve te Operatorit Ekonomik ankues nuk kemi te beje me korrigjim te gabimeve aritmetikore por kemi ndryshim te çmimeve për njësi për te cilat dispozitat ligjore te potencuar me larte nuk japin hapësirë qe këto çmime te trajtohen si çmime te korrigjuar. Bazuar ne listën e çmimeve për njësi te vendosura ne listën e çmimeve te ofertës se operatorit ekonomik ankues, ekspertja shqyrtuese konstaton se pretendimi i Operatorit Ekonomik është i pa bazuar. Ndërsa lidhur me pretendimin II ankimor rreth Operatorëve ekonomik te propozuar për dhënie te kontratës, dokumentet lidhur me formularët e plotësuar për Informata sekret afarist te dorëzuar ne ofertat e tyre kane dorëzuar si poshtë:

Numri i Prokurimit: **214-24-11463-5-1-1** -- Titulli NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR ZUBIN POTOK

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **POLICIA E KOSOVËS**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE /"NBT-ING"SHPK/ (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi ne pjesët e dokumenteve te dërguara:
Dosja e tenderit sekret afarist, lejohet vetem ajo pjese e dosjes sipas LPP-se.

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave leggjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Deklarate mbi natyren e dëmit te tille material dhe arsyet pse do te shkej te shfaqet:
Dokumentacioni i tenderit sipas nenit 68 dhe 69 te klasifikohet si sekret afarist dhe mos te ndahet me asnje pale tjeter siç percaktohet me LPP-se neni 11 Informatat Sekrete Afariste.Ndarja e ketyre informacioneve me operatore te tjere shfaq ,mumdesine e keqperdorimit te dokumentacioneve dhe informatave te kompanise tone.

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	"NBT-ING"SHPK
Adresa e plotë:	Rr.Dëshmorët e Atlantikut, pn
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Bexhet Baftjaraj
Pozita:	Drejtues Ligjor
Nënshkrimi:	
Data:	15.11.2024
Vula:	

112

B17 Dosjea e Tenderit – Pune – Procedur e Hapur

Për LOT 1 OE "NBT-ING SH.P. ka dorëzuar si më poshtë: Për LOT 2 GOE "Pro & Co Group SH.P.K; 2A Group SH.P.K. ka dorëzuar si më poshtë:

Numri i Prokurimit: **214-24-11463-5-1-1** – Titulli NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR ZUBIN POTOK

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **POLICIA E KOSOVËS**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *PRO & CO GROUP SHPK* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Të gjitha kërkesat në FDT të bazuara sipas neni 68 dhe 69

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Kjo kërkesë bazohet mbrojtjen e interesit të biznesit me mos dëmtim material të kompanisë dhe mundësisë së keqpërdorimit të këtyre informatave nga personat e tretë ashtu si na mundëson neni 11 i LPP

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	PRO & CO GROUP SHPK
Adresa e plotë:	Rr. Marigona Residence, pn, Llapnaselle, Gracanice
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Kenan Emini
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	15.11.2024
Vula:	

Ekspertja shqyrtuese lidhur me këtë pretendim te Operatorit Ekonomik e konsideron si pjesërisht te bazuar. Pasi qe tani Autoritetet Kontraktuese duhet bazuar ne: Rregullore Nr.002/2024 Për Plotësimin dhe ndryshimin e rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik e cila citon kështu:

Neni 7- Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion. 7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë: a. Informacionet në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP; b. Informacionet në lidhje me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP. 7.6.1 Autoriteti Kontraktues nuk do të klasifikojë një informatë si sekret afarist, nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së tenderit me të gjitha informacionet e kërkuara në këtë formular, me theks të veçantë poqëse nuk i ka paraqitë të gjitha faktet dhe argumentet me të cilat OE dëshmon se zbulimi i një informacioni do t'i shkaktojë dëm material biznesit të tij. 7.6.2 Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 "Njoftimi mbi vendimin e AK-së", duhet të përgatitë versionin e pastruar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 11 të LPP-së dhe të njoftojë palën. 7.6.3 Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët. 7.6.4 Me kërkesën me shkrim të një OJQ, e cila nuk është "palë e interesuar", siç përkufizohet ky term në paragrafin 1 nën paragrafin 1.26 të nenit 4 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës e cila kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 10 të LPP-së, përveç informatave sekrete afariste të

cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3 të nenit 10 të LPP-së, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur: a) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës (B08) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit (B09); b) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të LPP-së; ose c) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim (B10), sipas paragrafit 2 të nenit 62 të LPP-së ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur. 7.6.5 Jo të gjitha dokumentet e specifikuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë në përputhje me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, mund të klasifikohen si informata sekrete afariste. Dokumentet e specifikuara sipas nenit 68 e 69 të LPP e të cilat janë publike në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit. Duke u bazuar ne Dispozitat ligjore me larte ekspertja shqyrtuese potencon se ky pretendim mund te konsiderohet si pjesërisht.

Raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,Të mbetët në fuqi vendimi për dhënie të kontratës.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është deklaruar për mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik nuk është pajtuar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99

lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE AZ Building Development" L.L.C. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE AZ Building Development" L.L.C, janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin pjeserisht konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjeserisht të bazuara, nisur në faktin se OE ankues nuk ka pasur çasje te mjaftushme në dokumnetet publike të ofertuesve. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet aprovohet si pjeserisht e bazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i dates, 31.12.2024, për shpërblim me kontratë operatorin ekonomik për aktivitetin e prokurimit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës, lidhur aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Zubin Potok" me nr. të prokurimit: "214-24-11463-5-1-1", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0040, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues se sa i përket pretendimit ankimor se i është ofruar çasja vetëm në shikim ne Konpjuterin e AK-së në dokumente tenderuese të operatorit ekonomik ofertues, të cilat janë klasifikuar nga OE si informata sekrete afariste sipas nenit 11 i LPP-së, paragrafi 3 që përcakton: "Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere sipas ligjit...", në ketë rast Paneli shqyrtues tërheqë vëmendjen Autoriteti kontraktues për obligimin ligjor, se në rastet e dokumenteve konfideciale të propozuara nga

operatoret ekonomik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar, të bëjnë spastrimin e tekstit të dokumenteve të nenit 68 dhe 69 të LPP-së dhe t,ja ofrojnë palëve kërkuese. Paneli shqyrtues konstaton si pamjaftushme qasjen e ofruar nga AK ne kërkesën e OE ankues(vetëm ne shikim), por çasje ne dokumentet tenderuese të OE ofertues duhet jete konform nenit 10,11 të LPP dhe nenit 7 të Rregullores për Prokurim Publik,nr.01/2022, në kundërtën paraqet shkelje te neneve te lartëcekuara, andaj zyrtari përgjegjës i prokurimit i duhet të jete i vëmendshëm dhe të mos përsërit me casjen e pamjaftushme në dokumnete pasi që ato mund sjellin shkelje ligjore.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Zubin Potok" me nr. të prokurimit: "214-24-11463-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës, me përjashtim të çasjes në dokumente tenderuese, andaj dhe për këtë arsye ankesa është pjesërisht e bazuar.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjeserishem te ankeses të OE "AZ Building Development" L.L.C, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **AZ Building Development L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: